



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK**

**NDËRGJEGJËSIMI I PNEUMOLOGËVE DHE PACIENTËVE ME SËMUNDJE
RESPIRATORE NGA NDIKIMI I NDOTJES SË CILËSISË SË AJRIT NË SHQIPËRI
(TIRANË, ELBASAN, KORÇË, FIER, GJIROKASTËR, KUKËS, VLORË DHE
SARANDË)**

Qëllimi i studimit ishte krahasimi i ndërgjegjësimit të mjekëve pulmonologë dhe pacientëve me sëmundje respiratore i ndikuar nga ndotja e ajrit. Periudha e studimit është kryer gjatë vitit 2023.

Metodologjia

Studimi u mbështet mbi plotësimin e një pyetësori të standartizuar për: mjekë pneumologë/alergologë, të cilët e ushtronin profesionin e tyre në Spitale Rajonale, Klinika Ambulatore, Universitete si edhe pacientët e hospitalizuar, pacientët në klinikat ambulatore (dispanceritë), të cilët vuanin me sëmundje respiratore. Numri i kampionimit të studimit ishte 143 paciente dhe 28 mjekë.

Rezultate

Ky është studim që lidh demografinë e mjekëve me njohuritë dhe qëndrimin e tyre ndaj ndotjes së ajrit dhe tregon lidhjen midis njohurive dhe praktikave si dhe njohurive dhe qëndrimeve. Studimi pati rëndësi sepse gjeneruan rekomandime tek personeli shëndetësor mjek në lidhje me elementët ndotës të ajrit, si dhe u ndanë informacione me kolegë të tjerë në të cilët informacioni ishte i mangët. Gjithashtu thekson faktin që për faktorët e ndotjes së ajrit edukimi në vazhdim është një hap shumë i rëndësishëm.